



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 29 TETOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. OKTOBRA 2010. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2010**

E premte, më 29 tetor 2010, ora 10:00

Mbledhjen drejton: zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kërkoj falje, por akoma amendamenti dhe raporti i Komisionit për Komunitete nuk është bërë gati. Besoj se për 10 minuta po thonë që kryhet.

Po i bëjmë 10 minuta pauzë, pastaj të shohim.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, ministra të Qeverisë së Kosovës, hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 96 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Para se të procedojmë me rendin e ditës, Hydajet Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ka kërkuar fjalën për rendin e ditës.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që në emër të grupit nënshkrues të Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë dhe në mbështetje edhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, në konsultim edhe me deputetë të shumtë të të gjitha grupeve parlamentare, të shtroj kërkesën për shqyrtim dhe miratim të Ligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë. Duke pasur parasysh faktin se ky ligj është punuar nga vetë deputetët, duke pasur parasysh se është nënshkruar nga 83 deputetë, duke pasur parasysh faktin se komisionet kanë kryer punën e tyre, edhe pse do vështirësi me afatet janë, duke pasur parasysh se Komisioni për Legjislacion, që është komision që e mbulon këtë çështje, ka kryer punën në amendamente një javë më parë, por për shkak të kuorumit dhe angazhimeve që ka pasur me situatën e krijuar dhe Ligjin për zgjedhjet, e ka përmbyllur këtë çështje dhe duke pasur parasysh se është një ligj që është punuar në mënyrë konsensuale dhe është rast i përshtatshëm për ta përfunduar edhe në mënyrë konsensuale edhe aktivitetin ligjvënës të Kuvendit të Kosovës edhe karshi sprovave që kemi përpara, duke pasur parasysh se është paralajmëruar dhe është edhe në agjendën e mbledhjes, edhe duke u thirrur në nenin 84 të Rregullores, do të thotë duke u thirrur edhe në praktikën që e ka adoptuar ky Kuvend në pajtim edhe me praktikën parlamentare që në situata të veçanta edhe për t'iu shmangur rregullave dhe këtu është fjala vetëm për afatet që mund të jenë të diskutueshme për një ditë – dy, por duke marrë parasysh se është një ligj që është punuar nga vetë deputetët në mënyrë konsensuale, të gjitha grupet parlamentare, unë kërkoj mirëkuptimin tuaj që këtë ligj ta fusim në procedurë sot dhe ta miratojmë. Janë 83 nënshkrues dhe kjo nënkuptohet që është edhe përkrahja edhe për këto vështirësi procedurale. Nëse eventualisht konstatohet se ka nevojë të provohet, atëherë kërkesa është që të qitet në votim dhe të vendos, nëse do të jetë sot në procedurë apo në mbledhjen

vijuese. Kërkesa jonë është që të jetë sot në procedurë dhe unë besoj në mirëkuptimin tuaj. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ne çështjen në fjalë e kemi pasur në shqyrtim edhe në Kryesi sot. Kryesia, me qenë se nuk është respektuar koha sipas Rregullores, ka vendosur që ky ligj dhe emërtimi i një anëtarë apo kryetarit të propozuar në Komisionin e Prokurimeve, ka vendosur që ta bëjë në seancën e ardhshme. Megjithatë, me qenë se është propozim i grupit parlamentar të PDK-së së Kosovës, unë jam i obliguar që t'ua japë fjalën edhe grupeve të tjera parlamentare që të deklarohen lidhur me kërkesën e grupit parlamentar të PDK-së.

Në emër të LDK-së, fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ajo që e thatë ju, është e vërtetë se në Kryesi u bisedua dhe zoti Hyseni e tha që janë nënshkruar 83 deputetë, që do të thotë se janë të gjitha grupeve parlamentare, realisht. Ajo që ne i konsiderojmë dhe që e thamë në pjesën e fundit për shkak të procedurave, sepse ka qenë njëherë, është tërhequr, për shkak të procedurave, ne e mbështesim që të jetë në seancën tjetër. Edhe i respektojmë procedurat dhe e kryejmë këtë punë. Absolutisht, LDK-ja nuk e kundërshton dhe i kemi amendamentet pastaj, i shohim dhe nuk shohim që kjo të mos mund të bëhet në mbledhjen tjetër, pavarësisht çka do të jetë në rendin e ditës të asaj mbledhjeje.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të GP të AAK-së, deputeti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kjo kërkesë e sotme është dashur të përcillet me materialin që ta kenë deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe nënshkrimi i 83 deputetëve që të procedohet është shumë në rregull, që do të thotë se shumica e ka përkrahur formimin e këtij ligji, por është e çuditshme pse në Parlamentin e Kosovës ndodh në vazhdimësi me nga dy agjenda, me nga dy orientime dhe përsëri luhet me deputetët e Parlamentit të Kosovës. Unë i kam dy lista të rendit të ditës sot, në të njëjtën ditë, që nuk ka asnjë kuptim. Dje është dashur të merret vendimi dhe deputetët e Parlamentit të Kosovës ta kenë vetëm një rend dite, në mënyrë që të mos sjellin konfuzion. Prandaj, ligji është i domosdoshëm sepse ka të bëjë me kategorinë që ka dhënë shumë për vendin, por megjithatë duhet një procedim më i mirë, me një rend dite ashtu si duhet të veprohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Unë nuk kuptova asgjë, a jeni për ta futur sot si grup parlamentar në shqyrtim apo nuk jeni, se deklaratat janë diçka tjetër. Fjalën zotit Isufi, edhe njëherë!

AHMET ISUFI: E përmenda që në fillim se duhet të jetë me përcjellje të materialit, pa material si munden deputetët të punojnë. Kjo nuk është në rregull, prandaj silleni materialin, ligjin, me një rend dite, mos i bëni nga dy pika të rendit të ditës, të dalim ma serioz dhe normal që një ligj i tillë është i domosdoshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për seriozitetin, dy anëtarë të grupit parlamentar i ke pasur sot në mbledhje kur është vendosur për ta ndryshuar rendin e ditës, zoti Isufi, dy anëtarë të GP të

AAK-së , një anëtar i Kryesisë dhe kryetarin e GP i ke pasur në mbledhje të Kryesisë së Kuvendit dhe është vendosur së bashku me ta rendi i ditës.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Fole në emër të grupit parlamentar, të lutem!
Në emër të GP të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë do të përsëris atë që e kam thënë edhe në mbledhje të Kryesisë. Jam për t'u shqyrtuar në këtë seancë plenare ky projektligj për shkak se i ka plotësuar të gjitha kushtet që do të duhej t'i plotësojë në kalimin nëpër komisione. Nuk ka ndonjë arsye të veçantë për të mos u proceduar më tutje. Përkundër faktit që materiali është dorëzuar me vonësë, megjithatë konsideroj se është një ligj i cili do të duhej të kihej parasysh dhe do të duhej të miratohej sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të GP të LDD, Lulzim Zeneli .

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke pasur parasysh se kemi një ligj për të cilin nga fillimi e kemi përkrahur edhe iniciativën e krijimit të një projektligji të tillë, por njëkohësisht duke konsideruar se duhet të respektohen edhe procedurat, për LDD-në, grupin e saj parlamentar nuk është esenciale se a do të duhej sot Kuvendi i Kosovës të debatojë aq thellë për një projektligj duke ditur se, nëse janë proceduar të gjitha materialet e nevojshme dhe kemi arsyetimin se duhet të procedohet sot, për ne nuk ka problem a ta përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Grupi parlamentar "7+", nuk kanë deklaram. GP SLS, Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedavajući!
Poslanička grupa SLS podržace predlog Predsedništva.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar për Integrim, zoti Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti kryesues!

Moje će izlaganje biti vrlo kratko. Mislim da trebamo biti vrlo otvoreni i pošteni i da nije u redu da na zatvorenim sednicama Predsedništva, tamo gde nema javnosti, govorimo jedno, a na sednicama parlamenta pred javnošću govorimo drugo. Ako je dogovor na Predsedništvu bio, jer su bili predstavnici, članovi Predsedništva iz svih političkih stranaka, bio dogovor da se to danas ne razmatra, onda to treba da uvažimo. Mislim da uopšte nije pošteno pred javnošću da vas demaskiram potpuno, da jedno govorimo tamo a drugo govorimo ovde, odnosno oni koji govore. To je dvoličnjaštvo. Dakle, glasam za, mi kao grupa, za odluku Predsedništva da se ne stavi danas na dnevni red.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nëse hapim debat për këtë çështje, shkon gjatë puna.

Foli kryetari i Komisionit, Hydajet Hyseni dhe e vetmja mundësi është. Gani, të lutem, nuk ta kam dhënë fjalën. Ulu njëherë, ta jap nëse duhet për ta dhënë.

(Ndërhyrje)

Meqenëse komisionet e kanë shqyrtuar dhe i kanë bërë raportet, unë po ia jap fjalën kryetarit të Komisionit për Legjislacion, që ta thotë fjalën dhe nëse hapim debat më tepër, mua më duhet ta çoj deri në fund. Zoti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të ishte e rrugës që deputetët ta përkrahin propozimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që sot të votohet një Projektligj për një kategori të cilët kanë sakrifikuar shumë për Kosovën dhe, t'ju them të vërtetën, ka qenë edhe një angazhim i jashtëzakonshëm i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe unanimitet nga të gjithë anëtarët e të gjitha subjekteve politike që janë të përfaqësuara në komision, kanë votuar unanimitet për të gjitha amendamentet që nuk janë pak, janë 23 amendamente të cilat i kemi bërë në mënyrë unanime vetëm për të rregulluar statusin e ish të dënuarave, të burgosurve, të përndjekurve politikë. Do të ishte krejt, mos të them e pandërgjegjshme, por për një çështje krejt formale procedurale, pasi që Komisioni ka kaluar raportin, ka përgatitur amendamentet, amendamentet i kemi para vetes, kemi edhe raportet e komisioneve tjera që duhet të deklarohen për raportin, unë kërkoj si kryetar i Komisionit për Legjislacion ta përmbysim sot, ta votojmë projektligjin dhe sadopak t'i dalim në ndihmë kësaj kategorie dhe ta përfundojmë këtë obligim që na ka përcjellë nga mandati i parë i legjislaturës së parë në Kosovë e deri më sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk e shoh as si çështje të ngutshme, meqenëse të martën ka seancë të rregullt Parlamenti dhe kështu kemi vendosur. Zoti Beqiri e ka fjalën në emër të GP.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do të jem shumë i shkurtër. Unë po i lus kolegët dhe Grupi ynë parlamentar nuk pranon logjikën që dikush është për këtë ligj e ne nuk jemi. Kjo nuk është e vërtetë, nuk ka nevojë të bëjmë folklorizëm këtu. Ne jemi në mesin e atyre ndër të parët që e kemi nënshkruar dhe ne e përkrahim atë projektligj. Ajo që ne po kërkojmë, shumë është e thjeshtë. Nëse e kemi të martën seancën, bëjeni të hënën, na i bini amendamentet dhe ne e votojmë, asgjë të keqe nuk ka. Prandaj, për hir të asaj që e tha zoti Baliq, ka qenë shumë korrekt, Kryesia e ka marrë këtë vendim dhe ne u sollëm konform vendimit edhe të Kryesisë, por ajo që ne po e themi për të satën herë, nuk pranojmë në emër të grupit dhe të deputetëve të LDK-së që dikush tenton të manipulojë që dikush është për këtë projektligj e dikush jo. Ne jemi për të dhe po e lëmë fushatën. Të hënën mund ta caktoni seancën dhe e votojmë vetëm këtë projektligj. Çka ka rëndësi kjo punë? Ne jemi për të, vetëm çka po votojmë, kur nuk e kemi as letrën. Kjo është ajo. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Buja e ka fjalën në emër të grupit.

RAMË BUJA: I nderuar kryesues,

Konsideroj krejt të panevojshme këtë komplikim që u krijua, mocioni që u bë nga Grupi parlamentar i PDK-së duhet të vihet në votim dhe të shohim, u votua apo s'u votua, nuk e kemi këtë hall ne. Duhet të vihet në votim dhe të procedohet më tutje. Përse komplikohet situata, unë nuk e di. Mocioni i vënë nga një grup parlamentar vihet në votim, kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë po e di, por nga grupi parlamentar që ti e drejton, po kërkojnë fjalën, unë nuk mund tua marrë fjalën pasi u hap debati. Zoti Koci e ka fjalën.

GANI KOCI : Unë nuk do të flas rreth nevojës se a do të jetë sot, a do të jetë të hënën apo të martën, unë po ju drejtohem se materiali për këtë projektligj është dhe është në zyrat e sekretarisë dhe kam kërkuar që sot t'ju shpërndahet deputetëve dhe nuk e kanë shpërndarë atë material. Ne kemi vepruar me dy rende të ditës, me urgjencë na kanë thirr si Komision për Buxhet dhe Financa dhe e kemi përfunduar. Qysh më kanë thirr të martën, për 4 ligje që i kemi miratuar dhe është dashur të mërkurën urgjentisht të shqyrtohen dhe të futen në rend dite dhe nuk e ka ngritur askush si çështje se a janë respektuar afatet apo nuk janë respektuar afatet. Komisionit për Buxhet dhe Financa i kanë ardhur dhe pasdite rekomandimet e Komisionit për Legjislacion rreth këtij ligji, duke menduar se ashtu ka qenë që të jetë në rend dite sot dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka përfunduar sot dhe i ka rekomandimet e veta, i ka adresuar dhe ka kërkuar prej zotërinjve që t'ua shpërndajnë si secilin material tjetër dhe këta nuk e kanë shpërndarë atë material prandaj, ju lutem, është kërkesa që të vihet në rend dite, materiali është, unë kam kërkuar që të shpërndahet, është faji i atyre që nuk e kanë shpërndarë, pavarësisht se a do të jetë në rend dite apo jo.

KRYESUESI: Deputeti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit z. Kryesues!

Sinqerisht, për këtë projektligj është e vërtetë, jo vetëm që janë mbledhur nënshkrimet, por është bërë edhe një punë intensive në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, ndërsa sot është e pakuptueshme në këtë rast Kryesia e Kuvendit, konkretisht kryetari i Kuvendit se pse nuk e ka proceduar për rend të ditës, duke marrë parasysh që ka qenë edhe vendim i ditës së djeshme. Prandaj, nuk duhet të bëhen lojëra politike, as fushatë duke vizituar shoqata, por të bihet projektligji dhe të votohet pasi që e ka marrë shumicën edhe me nënshkrimin po nga këta deputetë të Kuvendit. E dyta, është shkelur edhe Rregullorja e Punës së Kuvendit. Për këtë ligj nuk ka dhënë mendim as Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila është e obligueshme sipas nenit 55 ta japë mendimin brenda një muaji, prandaj kjo është edhe një hile e kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit pse ky ligj nuk është sjellë sot në Kuvend. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Unë nuk dua që të polemizoj, por dua t'ju informoj që kryetari i Kuvendit ka qenë për ta futur në rend dite dhe ka qenë në diskutim sot, nuk i ka ra pishman asaj që e ka thënë, por gjatë diskutimit në Kryesi është parë e arsyeshme që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme për shkak të procedurave, jo për diçka tjetër. Kjo ka qenë. Deputeti Gani Geci e ka fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputet,

Ne në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi unanimitisht e kemi përkrahur këtë ligj. Pajtohem me kryetarin Bahri Hyseni që thotë se unanimitisht është përkrahur. E kemi pasur një problem të vogël, ai problem është tejkaluar, problemi se si do t'ia bëjmë me ish udbashët që kanë qenë të burgosur politikë dhe e kemi tejkaluar këtë. E kemi futur një nen të posaçëm, që kur të bëhet lustrimi i figurave politike, ata të paktën të mos kenë mundësi të gëzojnë benificione prej shtetit të Kosovës nëse kanë punuar për një shtet tjetër. Domethënë, ky ka qenë i vetmi problem, unanimitisht kemi qenë për dhe jemi për këtë ligj, por ata të cilët në një farë forme kanë hyrë në burg me detyra të caktuara dhe kanë kryer detyra të caktuara për shtetin e Serbisë, nuk do të

duhej që më vonë të konsiderohen si të burgosur politikë, por si bashkëpunëtor të Udbës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se shumicën e asaj që u deshtë të thuhet, e thatë ju, realisht. Në Kryesi të Kuvendit sot kemi diskutuar për ta sjellë këtë ligj në lexim të dytë sot. Ajo që ka mbizotëruar në bisedë, edhe njëherë po e përsëris që të jemi të qartë të gjithë, se emocionet po na bëjnë të flasim të gjithë njëjtë dhe të jemi të gjithë kundër njëri – tjetrit. Nuk kemi mund qysh t'ju themi deputetëve të votojnë një material që nuk e kanë para vetit. Kush i ka fajet pse materiali nuk është, nuk është aspak relevante, nuk është hiq me rëndësi çka ka ndodhur, pse nuk është materiali. Në të njëjtën kohë e dimë që të martën e kemi seancën e radhës dhe jemi marrë vesh që të martën ta fusim në rend të ditës dhe të votohet dhe nuk kanë dilema grupet parlamentare a ta votojnë apo jo. Nëse eventualisht kishte për të ardhur materiali, ne e votojmë, por prapë nuk ka nevojë urgjente të bëhet një gjë e tillë, që të na vijë materiali tash sot për sot, për shkak se e kemi seancën e radhës në të cilën duam ta votojmë, nuk është mbyllur kjo punë, nëse dikush është bash ashtu dhe mendon që as nuk ka për të pasur seancë të martën, Grupi Parlamentar i AAK-së nuk e ka asnjë telashe të votojë, por nëse na vjen materiali, mendoj se demokracia, është procedura dhe rregulla, nuk mund të themi se i respektojmë rregullat dhe procedurat, një herë i respektojmë dhe njëherë jo. Duhet të respektohen rregullat. Nuk munden deputetët e Kuvendit të Kosovës të votojnë diçka që nuk e kanë përpara. Nëse sillet materiali, e votojmë pa problem, por prapë propozimi ynë është se nuk kemi nevojë të bëjmë kështu, e kemi ditën e martë, e kemi seancën dhe e votojmë dhe mendoj se ka për të pasur koncensus. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit zoti kryesues! Unë në fakt po mendoj se të gjitha fjalimet janë nën ethe e seancës së fundit, me gjasë, dhe këtu po kërkohet të përshpejtohet diçka. Kisha propozuar diçka të mesit. Meqë është një pikë e rendit të ditës, të jepet një pauzë prej një gjysmë ore dhe besoj që sekretaria do ta bien materialin dhe, në fund të fundit, nuk është hera e parë që ne i kemi mbajtur edhe dy seanca brenda ditës, nëse edhe kolegët deputetë janë nën ethe se kjo është seanca e fundit për shkak të rrethanave politike që po dihen. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit zoti kryesues!

Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës e kemi shumë të qartë, sepse ndodhi veç para një gjysmë ore në mbledhje të Kryesisë dhe është mirë dhe është e domosdoshme që këtu të shprehen qartë pikëpamjet që shprehen edhe atje dhe në këtë kuptim unë pajtohem me zotin Baliq. Ky ligj nuk ka qenë në rend dite të Kuvendit, por ka qenë në rend dite të Kryesisë, diferenconi këto dy probleme. Po, e kemi pasur në rend dite të Kryesisë, ta diskutojmë a jemi në gjendje që ta aprovojmë, por jo në të Kuvendit. Kryesia e ka pasur Ligjin për zgjedhjet, këtë ligj dhe një të tretë, tri pika. Është marrë vesh Kryesia që të votohet sot vetëm Ligji për zgjedhjet, ndërsa ky ligj dhe i treti, dy të tjerat të diskutohen në seancën e parë të ardhshme. Ky është mendimi i Kryesisë në finale i të gjithëve, tjetër është se çka është diskutuar, por në finale, në krye me Jakup Krasniqin dhe të gjithë të tjerët që kemi qenë, jemi pajtuar kështu. Këtu janë njerëzit dhe mos t'i ndërrojnë fjalët. Tash këtu ka mocion, të jemi të qartë. Kuvendi po lyp ta

ndërrojë, Kuvendi ka të drejtë ta ndërrojë, nëse voton dhe është punë e tij. Unë këtu nuk po hyj, por megjithatë duhet të ketë sqarim, të jetë e qartë për këta deputetë të gjithë dhe për opinionin. Kryesia është marrë vesh që këto dy pika t'i kalojë..., ju tash thoni se kur, se po flitet këtu. Meqë e mora fjalën, unë po i them edhe këto dy fjalë. Kuvendi i Kosovës është duke punuar, Kuvendi i Kosovës edhe vetë kjo seancë ka të drejtë të caktojë pikë të rendit të ditës dhe ky Kuvend mund të caktojë seancë të hënën, ta shqyrtojë edhe këtë ligj dhe atë tjetrin, dy pika të rendit të ditës dhe ne punë të tjera nuk kemi, këtë punë e kemi. Mbledhemi të hënën, shpërndahet i gjithë materiali, e merr çdo deputet, e lexon deri të hënën dhe vjen e voton. Unë nuk di çka ka të keqe këtu. Pse të heqim dorë nga argumentimi. Propozimi im është, Kryesia, Kuvendi mund të vendos çka të dojë sot. Mocionin, normalisht, e ka lyp PDK-ja, por unë po ju them që është më e drejtë, është më e pastër, meqë paska konsensus total të Kuvendit, të merret vendim në Kuvend që për këto dy pika, unë po sugjeroj këtë dhe atë tjetrën, sepse e kishim edhe një pikë tjetër të rendit të ditës, që ishte materiali i regjistruar sot, le të thirret mbledhja të hënën me këto dy pika edhe nuk ka problem. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Zoti Buja, edhe njëherë.

RAMË BUJA: Po më duket se është një enigmatizim i panevojshëm i mbledhjes së Kryesisë dhe ajo është transparente, edhe ajo mund të transmetohet e transkriptet mund të shihen. Diskutimet kanë qenë, edhe i imi ka qenë ky përafërsisht, kështu i parafrazuar. Unë kam thënë që nuk ka asnjë problem që ky projektligj të procedohet për faktin që ka kaluar të gjitha procedurat. Është një defekt i vogël për faktin që kemi marrë vonë materialin, andaj nuk është votuar në Kryesi, edhe kryetari ka qenë për ta futur në rend dite dhe është bërë dilemë të futet apo jo dhe, në fakt, është kundërshtuar me këto fjalë që edhe këtu po kundërshtohen. Asnjë gjë e thënë ndryshe në Kryesi, nuk është thënë, andaj e drejta e grupit parlamentar ka qenë dhe mbetet që të paraqes mocionin dhe e drejta jote dhe obligimi yt, zotëri i nderuar kryesues, është që ta hedhësh në votim dhe a do të fitojë apo jo, është çështja.

KRYESUESI: Unë e kam të qartë atë, por unë nuk mund t'i ndaloj tash diskutimet pa u kryer, le të shfryhen krejt. E kemi hapur diskutimin, vetëm nëse tërhiqen deputetët, se unë nuk e kam ndërmend t'ua ndali fjalën. Deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që të gjithë deputetët janë që të procedohet ky projektligj, disa janë për sot, disa për të hënën. Përafërsisht po shihet epilogu i votimit eventual që mund të bëhet këtu. Unë kam një propozim, meqë ka një koncenus këtu, që të jepet ose ta kryejmë Projektligjin për zgjedhjet, kemi një pauzë deri në orën 14:00 që ta marrim materialin për Projektligjin për ish të dënuarit dhe në orën 14:00 të procedojmë me këtë projektligj në këtë seancë. Ky është propozimi im. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuari kryesues,

Po më duket se kemi hapur një debat të panevojshëm sepse dihet si procedohet, procedohet me mocione procedurale dhe në këtë drejtim ne duhet të veprojmë konform Rregullores së Punës. Është parashtruar një mocion në rendin e ditës dhe unë mendoj që duhet të votohet për mocionin. Nëse mocioni kalon, është në Kryesinë që të vendos se a është kjo çështje e pjekur për sot, apo të vazhdohet kjo seancë, jo seancë e re, të vazhdohet kjo seancë një ditë tjetër, kur materialet janë të

shpërndara, kështu unë mendoj se nuk duhet të vazhdojmë debatin më tutje. Duhet të votojmë për mocionin, nëse mocioni kalon, atëherë është në Kryesinë të vendos se a mund ta përgatisin për sot diskutimin për këtë çështje apo ta vazhdojmë këtë seancë të hënën apo një ditë tjetër.

KRYESUESI: Unë mocionin jam i obliguar ta qes në votim, por unë nuk po mund t'i heq këta që janë paraqitur për diskutim. Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Atëherë, dy fjalë sa i përket mocionit për të ndryshuar rendin e ditës. Unë edhe kur është ngritur iniciativa nga ana e Hydajet Hysenit, që ka qenë shumë me vend sa i përket hartimit të këtij projektligji, nevojës, qëllimit, rëndësisë dhe të tjera, mendoj se ka qenë me vend dhe po ta shikojmë në internet edhe atë se çka ka bërë Qeveria e Shqipërisë, atje ka edhe një pah më larg, jo vetëm projektligji, por aty në kuadër të Programit të Qeverisë dhe strategjive kryesore për qeverisjen e vendit, në vija të trasha është edhe strategjia për statusin e të burgosurve, kompensimin dhe gjithçka që ka të bëjë me këtë kategori të shoqërisë. Prandaj, asnjë dilemë nuk është dhe nuk ka qenë se kjo duhet të vijë në parlament dhe duhet të aprovohet, në mënyrën më të mirë, me amendamentim, por mungesa e materialit dhe vetë mocioni, u tha këtu, por u tha vetëm në foltore, në mungesë të materialit sa është sot, bie fjala, që sot të shqyrtohet në këtë moment, sa është në pajtim me vetë punën që e bën Parlamenti. Prandaj, a duhet pauzë, a duhet të shtyhet për ditën e hënë, a për ditën e enjte, një punë me kaq rëndësi, me kaq peshë të madhe, unë mendoj se nuk është të kryhet për 2 minuta, prandaj jam për variantin që kjo seancë të marrë qëndrimin që të futet në rend dite, por në një seancë tjetër, kur të na vjen materiali, cilën ditë, cilin moment që të vlerësohet se është më mirë. Kaq. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për mua është i tepër ky debat që u hap. Kërkesa e grupit parlamentar të PDK-së ishte shumë e qartë që ky ligj duhet të vendoset në rend të ditës sot. Nga praktikat e deritashme parlamentare të këtij Parlamenti është shumë e qartë që shumë herë kemi futur pika të rendit të ditës. Kur ka munguar materiali gjatë seancës, janë sjellë materialet dhe janë debatuar, është përfunduar dhe është marrë vendimi. E drejta e grupit parlamentar është e padiskutueshme që ka të drejtë të kërkojë futjen e një pike të rendit të ditës. Materialet, të gjitha komisionet funksionale po deklarojnë se materialet janë të përgatitura dhe ato kërkojnë që t'ju shpërndahen gjatë seancës deputetëve dhe sot të futet në rend të ditës. Kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përkrah qëndrimin e grupit tim parlamentar, mirëpo desha ta parashtroj nevojën e diskutimeve sepse gjithçka po diskutohet rreth procedurave, por gjithnjë po përmendet vetëm forma e procedurës se si mund të ndiqet, por asnjëherë nuk po e kuptojmë thelbin se çka përmban projektligji.

Edhe në projektligj, fatkeqësisht, si popull i kemi pësuar këto, sepse askush prej qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk ka pasur dëshirë të jetë i dënuar politikisht, më së pari.

Por edhe për Ligjin për vlerat e luftës dhe për të zhdukurit, duke i përfshirë këtu familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës, por edhe ky ligj që përmban një hapësirë shumë të përbashkët brenda vetes, më së shumti diskutohet në Parlamentin e Kosovës dhe bie sikur se gjithçka është e panevojshme, kur dihen për këto vlera. Ndërkaq, kam pasur dëshirë t'i shoh, në fillim të kësaj legjislature që po përfundon duke diskutuar gjëra të tilla, atëherë kur janë votuar ligjet për themelimin e komunave të reja serbe, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e të gjitha këto, atëherë nuk e ka ngritur askush, kur janë në pyetje vlerat tona si popull, neve diskutojmë dhe na mundojmë më së shumti procedurat. Dihet qysh ka qenë qëndrimi i përbashkët, se është pranuar për pakon, por atëherë nuk është diskutuar asnjë moment, a sot kur mundemi ta rregullojmë me procedurë, diskutohet edhe në këtë formë. Kërkoj falje, zoti kryesues, e zgjata pak.

KRYESUESI: Jo, jo, faleminderit!! Deputeti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Deshëm, s'deshëm, procedurat janë relevante, se çfarëdo pune që do të bënim me qëllimin dhe me profesionalizmin më suprem të mundshëm, sikundër të bënim çfarëdo pune në kolizion me procedurë, do të dilte se nuk është punë valide.

Prandaj, unë angazhohem për procedura dhe ato që i kemi miratuar, i kemi që janë valide. Po, gjithsesi, unë konsideroj se propozimi i zotëriut Buja, i zotëriut Bajrami, Grabovci është me vend dhe ne duhet të votojmë për propozimin e grupit. Gjasat janë që nuk do të kalojë, por nëse kalon, kalon, nëse nuk kalon, veprojmë, prandaj angazhohem që të votojmë dhe të shohim. Dhe, fundi i fundit, këtë temë mund ta spostojmë për ditën e hënë apo të martën dhe ta vendosim në konformitet me procedurat. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

I fundit është deputeti Driton Tali. Nuk ka tjerë. Nuk do, tërhiqet. Atëherë, debat më nuk ka. Janë paraqitur disa, për së dyti e së treti edhe nga PDK-ja dhe nga AAK-ja, por nuk ka kuptim.

Unë e hedh në votim dhe, ju lutem, regjia ta qes në votim. Problemi është që nëse miratohet që sot të shqyrtohet, votojmë "për". A i keni propozimet, se janë tri propozime, në fakt. Një propozim është për sot në orën 14:00 ta vazhdojmë seancën. OK. OK. E dimë ne Ramë, të lutem! Të lutem, mos më ndërprej tash se jam duke udhëhequr mbledhjen.

Është mocioni, është propozimi për sot, në ora 14,00, nëse kalon mocioni, dhe është propozimi pastaj për të hënë. Tri propozime janë.

Megjithatë, unë po e vë në votim mocionin e Partisë Demokratike që të shkojmë me procedurë për ta miratuar këtë ligj menjëherë dhe kjo nënkupton që sot në orën 14:00 mund të mbahet seanca. Nëse nuk kalon, atëherë e lëmë për një seancë të re, ditën e hënë.

Pra, e vë në votim këtë.

Në sallë janë 97 deputetë. Votojmë tani:

Ju faleminderit! Kalon mocioni, miratohet mocioni për ta miratuar ligjin. Janë 46 deputetë "për", 30 "kundër", 5 abstenime.

Në orën 14:00 procedojmë me ligjin. Kërkoj që amendamentet të shpërndahen, mundësisht sa më shpejt nga administrata, dhe kërkoj nga Komisioni për Komunitete që gjatë pauzës ta shqyrtojë dhe Kuvendi t'i paraqitet raporti i Komisionit për Komunitete.

Ju faleminderit! Pra, pas miratimit të Ligjit për zgjedhjet, në orën 14:00, kemi vazhdimin e seancës me pikën e dytë të rendit të ditës.

(Sugjerime, propozime)

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas aprovimit në parim të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, konform nenit 57, pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2010, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-073 dhe Kuvendit i propozon këtë raport.

Propozon që të ketë 3 amendamente, të cilat janë amendamente të Komisionit për Legjislacion dhe, natyrisht, do t'i përmend edhe amendamentet të cilat kanë ardhur nga deputetët: Driton Tali dhe Emrush Xhemajli dhe një amendament që ka ardhur nga Grupi Joformal i Grave.

Vlen të theksohet se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi kërkon që amendamenti i tretë, që e kemi bërë vetë si amendament, që ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit, kërkoj që seanca plenare ta modifikojë amendamentin duke marrë parasysh se ne kemi shkuar sipas praktikës dhe sipas Kushtetutës në fuqi, si hyjnë ligjet në fuqi, mirëpo duke marrë parasysh që jemi në një situatë krejtësisht të jashtëzakonshme, kërkoj që amendamenti i tretë të jetë që ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit nga presidenti në detyrë.

Dhe arsyen po kuptoni të gjithë, për shkak që Komisioni Qendror Zgjedhor ta ketë mundësinë që ditën e dekretimit menjëherë të fillojë parapërgatitjet për procedurat e mëtutjeshme për ligjin.

Ju njoftoj, të nderuar kolegë deputetë, se kemi 2 amendamente të deputetëve: Emrush Xhemajli dhe Driton Tali, që kanë të bëjnë me prapësinë të zgjedhor. Të dy amendamentet janë të njëjta, ku kërkohet që prapësinë të jetë 3% për subjektet politike dhe 1% nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend.

Ju njoftoj se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk iu ka dhënë përkrahje këtyre amendamenteve, duke marrë parasysh që paraprakisht ne kemi pasur një grup punues dhe në grup punues kanë qenë përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike parlamentare, kanë qenë

përfaqësues edhe të Shoqërisë Civile, përfaqësues edhe të Grupit Joformal të Grave, ka qenë edhe prezenca e faktorit ndërkombëtar dhe unanimisht jemi pajtuar që pragu prej 5% të mos futet në plotësim-ndryshimet e Ligjit për zgjedhjet.

Domethënë, Kuvendi i Kosovës, dje në parim, e ka votuar Projektligjin pa propozim të ri për ndryshim të pragut zgjedhor, prag të cilin e kemi bartur nga e kaluara në dy ligjet që kanë qenë në fuqi deri më tash për zgjedhje.

Sa i përket propozimit të tretë, që vjen nga deputetja Flora Brovina, që ka të bëjë me nenin 110, paragrafi 4, ku thuhet në fjalën e parë dhe të dytë, fjalët, “për një kandidat”, zëvendësohen me fjalën “për 10 kandidatë”, prapë Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi unanimisht nuk e ka përkrahur këtë amandamet duke marrë parasysh që plotësim-ndryshimet në Ligjin për zgjedhjet më nuk kanë qenë në një kandidat, por janë në pesë kandidatë. Domethënë, referimi ka qenë për ligjin i cili ka qenë në fuqi, por jo edhe për plotësim-ndryshimet e ligjit aktual. Do të thotë, çështja është që në ligjin për plotësim ndryshimet, që e kemi kaluar dje në parim, kanë qenë pesë kandidatë, prandaj këto janë arsyet për të cilat nuk i kemi përkrahur këto amendamente.

Kërkoj që deputetët e Parlamentit, meqë ka pasur një unifikim edhe në Komisionin për Legjislacion, por edhe në grupin punues për zgjedhjet, t'i përkrahin amendamentet e komisionit funksional. Pra, me këtë ndryshim që e thashë për hyrje në fuqi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të komisionit, Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë po e shpreh vetëm një vlerësim lidhur me raportin, me amendamente, shkurt me dy fjalë, se ajo çka doli si rekomandim i përgjithshëm dje në debatin që patëm, nisur nga vlerësimi për projektligjin, peshën politike që e ka dhe ajo çka pritet nga projektligji me ndryshime, kemi vlerësimin se nuk e ka përmbushur atë detyrë dhe atë mision komisioni.

Sinqerisht po i them Bahriut, dhe shokëve, kolegëve të tjerë se me këto amendamente nuk është ndryshuar asgjë nga ajo çka kemi pasur ditën e djeshme, përkundër atyre sugjerimeve dhe pranimeve në parim debat.

Kam pritur më shumë dhe nuk e di a ka më mundësi dhe kohë që kjo punë të bëhet lexim të tretë në javën e ardhshme, sepse kështu si është ky raport, me këto amendamente është tepër i zafët. Pra, nuk e kemi kryer misionin për të cilin kemi dëshiruar që të përgatisim një projektligj si duhet. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! E ka fjalën Sanije Alijaj, në emër të Komisionit për Komunitete.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë e kam për obligim në emër të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të jap një sqarim. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për Komunitete dhe me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ai, në kuadër të këtyre përgjegjësiave, ka për obligim, objektiv pune që të bëjë vlerësimin e amendamenteve të komisionit funksional.

Në takimin e sotshëm është konstatuar se amendamentet e komisionit funksional nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Por, në takim doli një propozim nga zoti Rexhep Hoti, që pragu zgjedhor të jetë 3% për komunitetin shumicë apo subjektet politike të komunitetit shumicë dhe 1% për kandidatët e pavarur, dhe ka gjetur përkrahje nga shumica e anëtarëve të komisionit.

Mirëpo, edhe një herë po e vlerësoj: Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, me amendamentet e komisionit funksional nuk preken të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të komisioneve të përhershme, nuk ka të paraqitur. Tani fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se një pjesë të asaj që e tha deputeti Bahri Hyseni duhet të përsëris se qëndron.

Mos harroni se, realisht po i them Kuvendit, jo juve, më falni, ka pasur një grup punues për Ligjin për zgjedhjet dhe është praktikë parlamentare.

Arsyeja pse ka pasur grup punues, është që Ligji për zgjedhjet i cakton rregullat e lojës, i përcakton rregullat me cilat partitë politike kanë për të marrë pjesë në zgjedhje dhe synohet që këto rregulla të jenë të pranueshme për shumicën, të paktën për shumicën dërmuese të akterëve politikë. Kjo është arsyeja e vetme pse ka grup punues dhe që nuk shkohet drejtpërdrejt në kuvend ku mund t'i marrë 61 vota.

Këtë po e them për shkak se duhet pasur kujdes që amendamentet dhe votat të cilat dalin sot nuk guxojnë të jenë kundër vendimeve konsensuale të grupit punues për shkak se atëherë nuk kemi të bëjmë më me rregulla të lojës konsensuale.

Ky ligj është i karakterit të tillë që kërkon një konsensus të gjerë dhe nuk mund të bëjmë amendamente sot, ose dje - të cilat dalin kundër vendimeve të grupit punues, për shkak se atëherë prishet konsensusi, dhe nëse prishet konsensusi, kemi për të pasur të drejtë të themi që nuk janë në rregulla të lojës me të cilat jemi pajtuar të gjithë.

E pash të arsyeshme edhe një eko t'i bëjmë asaj që e tha deputeti Hyseni, për shkak se është ligj tepër i ndjeshëm, ligj për të cilin ndoshta kemi pasur nevojë edhe për më tepër kohë të marrim një grup punues, mirëpo kaq e kemi pasur kohën dhe deri këtu kemi mbërri.

Me siguri se ligjet zgjedhore, sikur në të gjitha vendet e botës, do të përmirësohen edhe këtu në vazhdimësi. Nuk kemi ligj i cili përfundimisht i përmbush nevojat e Kosovës, mirëpo në këtë fazë subjektet politike dërmuese në Kosovë kanë arritur deri në këtë konsensus dhe duhet t'i lusim deputetët e Kuvendit të Kosovës ta respektojnë këtë konsensus deri tash. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Desha të bëj një sqarim. Kërkoj që amendamentet që i kam bërë unë e që i kanë përkrahur edhe disa komisione, dhe që i ka bërë edhe deputeti Tali, të votohen. Janë bërë në procedurë të rregullt, në kuadër të punës që e bën Kuvendi. Pas mbledhjes dje, që i kemi kryer këtu, iu kanë drejtuar amendamentet përmes protokollit Kuvendit. Ato janë protokolluar dhe i kanë shkuar komisionit. Komisioni i ka trajtuar në mënyrën, siç thanë zoti Hyseni edhe Gjini. Ndërkaq, dua të sqaroj se edhe grupi punues është respektuar, grupit punues i është drejtuar një letër nga pesë subjekte politike, në të cilat kërkohet ulja e pragut nga 5% në 3%.

Këto mund edhe të shikohen. Ja kjo është, e keni të gjithë përpara këtë letër dhe le të thotë grupi punues që e ka pasur mbi tavolinë. Kjo është e protokolluar, i është drejtuar kryetares - zonjës Valdete Daka, më 14.10.2010, shumë më herët sesa që ka mbajtur komisioni mbledhje. Pra, pse kjo shkresë është fshehur dhe nuk i është dhënë grupit të punës?

(Ndërhyrje)

Jo, jo, nuk është trajtuar në grupin e punës, pra paska qenë në procedurë të rregullt, sepse ai grupi i punës duhet t'i marrë parasysh shkresat të cilat i drejtohen. Prandaj kërkoj që të votohet, sepse është në të mirën e përfshirjes së gjithë qytetarëve të Kosovës në procesin elektoral, edhe në të mirën e alternativave të reja për vendin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk do t'i shtoj asgjë asaj që e sqaroi shumë mirë deputeti Ardian Gjini, por edhe një herë do t'ia bëj me dije Kuvendit, dhe sa për njoftim edhe përfaqësuesit e Komisionit për Komunitete.

Kemi pasur dy përfaqësues në grupin e punës nga partitë politike që vijnë nga komunitetet, dhe ata kanë votuar që të mos preket pragu zgjedhor. Domethënë, ka qenë një konsensus i plotë i të gjitha subjekteve politike.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, nuk ka ndërhyrë dhe nuk e ka pasur autoritetin të ndërhyjë atje ku ka pasur konsensus politik. Zoti, Emrush, është e vërtetë që kemi diskutuar në grup punues për pragu. Kemi diskutuar bile mjaft, në dy-tri seanca, mirëpo unanimisht të gjitha subjektet politike, përveç një anëtari nga shoqëria civile që ka qenë kundër, të gjithë kemi qenë që pragu të mos futet në plotësim- ndryshime.

Prandaj, ju kisha lutur që, nëse tejkalojmë konsensusin politik, ne mund të vijmë një situatë, komplet për Ligjin për zgjedhjet. E tha mirë edhe Ardiani. Dhe është edhe një çështje. Ne e kemi marrë rekomandimin që ka ardhur nga Komisioni i Komuniteteve që thotë- përkrahet, por, ju lutem, nëse e lexojmë, paragrafi 2 thotë kështu:

Komisioni e ka shqyrtuar raportin me amendamentet e Komisionit funksional dhe e ka miratuar propozimin. Nëse e keni miratuar propozimin, atëherë seanca nuk ka nevojë... Ju keni mundur ta jepni me rekomandim që e përkrahni apo nuk e përkrahni, sepse komisionet nuk miratojnë, por vetëm rekomandojmë për miratim apo për çështje që nuk e miratojnë.

KRYESUESI: Zoti Xhemajli, kërkon replikë.

EMRUSH XHEMAJLI: Kam të drejtë! Faleminderit, zoti kryesues! Mjerë ai Kuvend që e pranon logjikën që s'paska të drejtë Kuvendi për t'i bërë ndryshime tekstit që e bie një grup sado i rëndësishëm qoftë. Edhe nuk ma merr mendja që prishet konsensusi nëse ulet pragu zgjedhor nga 5 në 3, sepse AAK-ja dhe PDK-ja, përkatësisht subjektet që i përfaqësojnë këto dy parti kanë ardhur në atë shkallë sa që mos ta kalojnë këtë prag, kështu që nuk ka pse kjo të mos votohet.

(Ndërhyrje)

Atëherë, nuk e besoj që grupi do të jetë në zgjedhje. Por, sidoqoftë unë kërkoj që mos të merremi me procedura, por me esencën e problemit, sepse edhe me procedura është gjithçka në rregull. Ka, dy-tri herë amendamente prej dy-tre deputetëve, kështu që ju lutem të procedohet ma tutje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Është shumë e qartë, ajo që e bëmë për pikën paraprake, që duhet vendosur, u vendos. Për këtë pikë, përpos referuesve të komisioneve që e kanë obligim, është në lexim të dytë, prandaj, ju lus qitni rekomandimet dhe jo kujt të na teket, vetëm sa për të folur.

Ju lutem i keni rekomandimet dhe absolutisht nuk kemi të drejtë ta marrim fjalën më për këtë çështje jashtë asaj që i ka propozuar Komisioni dhe vendosim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Edhe unë kisha pasur dëshirë të jetë ashtu, por Rregullorja mua nuk ma jep këtë të drejtë të autoritarizimit në foltore, prandaj jam i obliguar që para çdo amendamenti, secili deputet i Kuvendit të Kosovës, ka të drejtë ta marrë fjalën.

Jo, dy herë s'shkon ta marrësh fjalën.
Deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit!
Zoti kryesues e mora fjalën të them se amendamenti i pestë nuk është amendamenti personal imi, por është i Grupit Parlamentar të Grave...

KRYESUESI: Është mirë të presim kur të vijë amendamenti. Pra ende nuk kemi ardhur tek amendamenti.

FLORA BROVINA: Unë desha të shpjegoj, sepse këtu u fol për këtë amendament, prandaj, duhet ta them.

KRYESUESI: Jemi tek amendamenti i parë.
E ka fjalën Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Këtë amendament e kanë nënshkruar edhe 84 deputetë dhe Kryesia e Parlamentit nuk e ka parë të arsyeshme si mocion ta shqyrtojë në veçanti. Ndërsa, amendamenti nuk është shqyrtuar as në grupin punues, sepse atje ne nuk kemi qenë të barabartë, por kemi qenë vetëm si këshillëdhënëse, pra kemi marrë pjesë pa të drejtë vote. Motivi për këtë amendament është i shumëfishtë, sepse dihet që të të gjitha partitë elitën partiake e kanë burrat, dhe është e vështirë gratë të depërtojnë në mënyrë të barabartë dhe të konkurrojnë për të marrë vota. Nuk është e drejtë që ato të hyjnë në Parlament vetëm me kuotë. Këtë pozitë nuk e kemi pranuar, prandaj shohim shansin tonë nëse votohet me më shumë kandidatë se sa si është dhënë këtu me pesë deputetë, sepse dihet që çdo e treta në listë duhet të jetë femër. Dhe së fundi, motiv më shumë për ta votuar këtë amendament, të cilin e propozojmë është edhe diskutimi ose debati që pat zëvendëskryeministri me njërin deputet kur tha se ne nuk shtyhem me gratë. Ne do të shtyhem me burrat, me kualitetet tona, me vlerat tona, me kapacitetet tona, dhe me pozitë të barabartë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë kërkoj që ta ndërpres debatin dhe të vazhdojmë për amendamentin e parë për ta votuar dhe në qoftë se ka dikush diçka konkrete për amendamentin e parë, le të paraqitet.

A ka dikush të diskutojë për amendamentin e parë, apo s'ka, a po e miratojmë? Janë paraqitur disa më herët për diskutime. I lus që ta tërheqin fjalën të gjithë ata që s'kanë për të diskutuar për amendamentin e parë, që të mos thotë dikush që nuk ma dha fjalën.

Pra, fjala është për amendamentin e parë.

Në sallë janë 75 deputetë.

Votojmë tani amendamentin 1.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tani.

S'ka të paraqitur, miratohet amendamenti 2.

Tek amendamenti i tretë ka një kërkesë kryetari i Komisionit për Legjislacion, që në vend të asaj që thuhet në amendament se ky ligj hyn në fuqi, 15 ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovë, të futet, ditën e dekretimit për arsye që u cekën. Mendoj që duhet të votohet.

Votojmë tani me ndryshimet që u propozuan.

Zoti Tali, a jeni paraqitur për amendamentin e katërt?

Ju faleminderit.

Miratohet amendamenti i tretë.

Amendamenti i katërt.

Zoti Tali e kërkon fjalën.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë edhe një herë po apeloj te deputetët, tash e kanë rastin, shansin që të vendosin se çfarë Parlamenti dëshirojnë të kenë në legjislacionin e radhës? A dëshirojmë të kenë një Kuvend të orkestruar, siç e quanin disa kritikë këtë Kuvend, apo një Kuvend ku do të marrin pjesë të gjitha

grupet e interesuara të qytetarëve, përfaqësuesit e qytetarëve. Unë mendoj se tash e kemi rastin që të vendosim të votojmë se a dëshirojmë një Parlament ku do të debatohet, ku do të ketë pluralizëm të ideve, apo dëshirojmë, po them edhe një herë një Kuvend ku udhëheqësit e fuqishëm ta diktojnë Kuvendin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,
Kolegë të nderuar,

E mbështes amendamentin që i referohet 1% për deputetin individual. Angazhohem që termi i ashtuquajtur “deputet i pavarur” është konstrukcion juridik i palogjikshëm, sepse se paku deri tash nuk ekziston ai term, por nëse do ta miratonim, do të dilte se do të kishte Kuvendi i Republikës së Kosovës, deputetë të pavarur, edhe deputetë të varur. Me lejen e zotëri Ramë Bujës që është shëf i Grupit Kuvendar më të madh, do të dilte se zoti Buja do të ishte deputet i varur apo zoti Makolli, një non sens, deputet individual. Secili deputet, fundi i fundit është pavarur atje në dispozita ku thotë sipas ndërgjegjes e koshiençës, e bindjes e tjera e tjera. Ama i pavarur nëse do ta pranoni këtë term, atëherë automatikisht do të kuptojë se ata që nuk janë individualisht të zgjedhur do të ishin të varur. Pra, angazhohem që të miratohet ky amendament po me shprehjen, deputet individual 1%, nuk do të ketë demokraci të mirëfilltë në qoftë se nuk do të kishim sa më shumë që është e mundur deputetë individual. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Hoti e ka fjalën.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Më lejoni së pari të sqaroj që kryesuesja e Komisionit për Komunitete nuk duhet të bënte sqarime, por duhet ta jepte një arsyetim në një mënyrë shumë korrekte dhe shumë të drejtë. Ne duhet të mësohemi t’i respektojmë rregullat dhe atëherë kur nuk na pëlqejnë, prandaj ajo duhet ta bënte arsyetimin e Komisionit, i cili ka votuar pro propozimit të zotit Tali, amendamentet e propozimit të z. Tali .Kjo është e para. E dyta, këtu u fol për konsensus, ju lus dhe i lus deputetët të mos krijojnë monopole, me anë të subjekteve politike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, shtetit më të ri në botë ka bërë përjashtime dhe ka bërë aprovimin e dispozitave kushtetuese në bazë të individëve të caktuar të Kosovës të cilët kanë përfutur personalisht. Në qoftë se ne japim këso porosi për proceset të cilat duhet ta shpien shtetin e ri, japim për të treguar se ata që janë në krye që e përdorin shtetin për interesa shumë personale. Ju kisha lutur që konsensusi i subjekteve politike të ketë konsideratë të jashtëzakonshme ndaj partive politike që janë në pakicë. Dhe, e treta, Kushtetuta e Kosovës, meqenëse nuk i definon se cilat janë kombet në Kosovë, por merret vetëm me komunitete, në këtë rast e shfrytëzoj Kushtetutën e Kosovës për të thënë se një komuniteti pakicë shqiptare, i cili dëshiron të hyjë në Parlamentin e Kosovës, po i bëhet e padrejtë për shkak se po diskriminohet në raport me komunitetet tjera jo shumicë të cilat mund të hyjnë në Parlament si të duan. Prandaj ju kisha lutur mos i diskriminoni njerëzit dhe Kosova nuk duhet të vuajë nga monopoli për t’i u privuar të tjerëve nga të drejtat për t’u përfaqësuar. Plotësisht duhet në Kosovë të ketë të drejtë një individ të zgjidhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili është në gjendje të marrë vota në përpjesëtim sa çdo deputet i Kuvendit të Kosovës dhe është diskriminim në qoftë se është një deputet i themi se ai

duhet t'i marrë 5% për ta për ta përfaqësuar votën, vetveten, ky është diskriminim i hapur, prandaj ju jepni shansin njerëzve të mos krijojmë më monopole...

Këtë kur e them, i kam parasysh fëmijët tanë edhe ju kam parasysh, sepse nuk shkohet me këtë logjikë. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI: Deputetja Sanije Aliaj, replikë.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë para Kuvendit kërkoj vëmendjen e deputetëve. Sot Komisioni për Komunitete i ka kaluar kompetencat dhe përgjegjësit e tij, edhe përkundër vërejtjes që ia kam dhënë si kryesuese, Komisioni ka të drejtë të japë amendamente vetëm kur shkelen të drejtat dhe interesat e tyre, por propozimi i zotit Hoti me argumentet që tash i ka dhënë në Kuvend, që i ka ofruar Komisionit, ka kaluar si propozim, pranohet propozimi i amendamentit i zotit Tali. Është e drejtë e tij, por mbi të gjitha raporti i Komisionit për Komunitete sot është jashtë kompetencave të Komisionit. Unë e njoh ligjin, i njoh përgjegjësitë me rregullore që e udhëheq këtë komision, dhe kam qenë kundër këtij amendamenti që ka ardhur, por jam detyruar ta nënshkruaj për shkak që e udhëheq Komisionin. Ju faleminderit!

KRYESUESI – Ju faleminderit!

Deputeti Naim Rrustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk kam shumë çka t'i shtoj fjalimit të shkëlqyeshëm të zotit Hoti, me fjalët që eksploatoi shumë drejt dhe saktë se çka me të vërtetë do të thotë zhvillimi adekuat i jetës demokratike, por edhe një herë do t'ia përsëritsha zotit Hyseni si përfaqësues i Komisionit dhe me fjalët që erdhi nga grupi punues se përpjekjet për gjetjen e konsensusit në grupin punues janë demokratike, mund të vendosen rregullat e lojës, por konsensusi, përpjekjet përfundimtare janë në Kuvend. Kur i kemi parasysh këto fjalë që aq shumë i keqpërdorëm lidhur me gjetjen e konsensusit apo rregullave të lojës demokratike, atëherë mund t'iu them se pikërisht diskutimet e tilla janë në kundërshtim me të, sepse demokracia perëndimore, pikërisht mbështetet në përpjekjet e vazhdueshme për gjetje të konsensusit, dhe sa më i vogël është pragu, aq më e madhe është përpjekja për gjetje të konsensusit dhe demokracia është vetë përpjekja për gjetjen e konsensusit.

Me vendosjen e pragut për 5% është një përpjekje për mbyetje apo ngufatje të demokracisë. Fjalimet e paraprake që u thirren shumë në grupet punuese vetëm e tregojnë kërkesën për dominim për vendosje apo gjeja dominim nuk dihet kurrë deri në përfundimin e zgjedhjeve, por ishte e qartë se ishin fjalë në kundërshtim njëra me tjetrën, kishte kundërshtim të ideve, edhe konsensus të gjesh edhe ta mbash prapun 5%, është kontradiktore, është paradoks, sepse ti kërkon ta kesh prapun 3% , të ketë më shumë parti, për të bërë përpjekje për të gjetur konsensus. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ky amendament që është propozuar nga zoti Tali, meriton vëmendje pak më të mirë, një vesh pak më demokratik nëse mund ta kemi. Është thelbësor kujtoj jo për gjitha standardet, dhe për

ato ndryshime të cilat pretendohet t'i ketë sistemi zgjedhor për demokracinë, për përfaqësimin në Parlament. Është mirë, pra në qoftë se nuk kemi diçka tjetër për ngut sidomos, Armendi, ky shoku im këtu le të dëgjojë pak se është i ri dhe duhet të jetë më demokratik, më demokraci këtu. Arsyeja është kjo, pjesa e cila ka të bëjë te propozimi i ofruar, që e thanë kolegët më herët, unë po e them një herë duhet të vlerësohet mirë për t'i përmbushur ato standarde edhe për të bërë një përfaqësim edhe ma të mirë në Parlament.

Unë po e jap një argument nga aritmetika politike, gjegjësisht e përfaqësimit në Parlament te pjesa që ka të bëjë këtu me kandidatin e pavarur, ku kërkohet 1% që është shumë me vend, ndryshimi, sepse ne në Parlament i zgjedhim 100 deputetë, një qind vende dhe nëse kërkohet për një kandidat të pavarur në përfaqësim të marrë mandatin e qytetarëve me 3%, bie fjala, atëherë i bie raporti 3 me 1, me një mesatare e deputetëve që hynë në parti. Është e padrejtë a, shikojmë nga ai këndi, pra nga ai balansi si përfaqësohet në votë e atij i duhet ndoshta nesër t'i merren 15000 vota e një deputeti që hyn nga partia mundet me 5000 ose 6000 ose me 100 vota? Prandaj, kjo është për t'u vlerësuar, mendoj që është me vend, sepse nga 100 vende, një deputet, shprehur në përqindje është 1% e jo 3% apo më shumë, kështu që e vlerësoj me shumë interes këtë amendament gjatë këtij debati dhe mendoj se kjo pjesë në këtë pikë duhet të ndryshohet dhe të aprovohet se është me interes për një përfaqësim dhe për një sistem përfaqësues më demokratik në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Ismail Kurteshi e ka fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Ju faleminderit, kryesues!
Unë konsideroj që atyre që dëshirojnë që individualisht të garojnë për deputetë duhet t'u mundësohet që me 1% të votave të hyjnë në Kuvend se ai është proporcioni i drejtë për secilin deputet. Ata që po e mbrojnë pragu prej 5% është interesant se edhe pse e dinë që këtu në Kuvend përmes këtij pragu kanë hyrë njerëzit me 150 vota e nuk po i pengojnë dhe përfaqësojnë vetëm 150 qytetarë, por po u pengojë ata që realisht, pavarësisht se a do të jenë deputetë a jo nëse e kanë përkrahjen e 1% të popullit d.m.th. proporcionin e duhur, ata natyrshëm janë deputetë të Kuvendit.

Sa përket konsensusit, ai konsensus në mes të partive më të mëdha të cilat nuk po e qajnë kokën fort për kualitetin në Kuvend, por më tepër për interesat e tyre, sepse unë para disa dite kam lexuar deklaratat e shefave të tri grupeve ma të mëdha parlamentare këtu në këtë Kuvend, të cilët kanë qenë në parim për zonat elektorale të jenë 7 ose 8 zona, kurse tash kanë qëndrim tjetër, prandaj është mirë vërtet të jemi parimor dhe njerëzve t'ua mundësojmë që t'i shfrytëzojnë atë që u takon natyrshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues!
Pas krejt këtyre debateve, ne si grup parlamentar kemi nevojë të kemi një konsultë të shkurtër dhe kërkojmë një pauzë të shkurtër.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk e keni potencuar sa minuta, por unë jam i detyruar ta lejoj pauzën, janë edhe 5 diskutues të paraqitur. Pra, marrim pauzë 15 minuta a, apo më shumë?

Vazhdimi i seancës pas pauze

Po vazhdojmë me Ligjin për zgjedhjet, shqyrtimin e dytë të Projektligjit, për ndryshim dhe plotësim.

Kemi mbetur tek amendamenti 4, me diskutime.

Radhën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të falënderoj edhe që ma dhe fjalën po edhe që e ke lejuar debatin të bëhet për këtë ligj, për shkak se nga disa diskutues që thanë deshëm të paraqesin si një fakt të kryer, gjëja dikush është marrë vesh jashtë Kuvendi dhe Kuvendin ta paraqesin si një organ të parëndësishëm sa i përket ligjit për zgjedhje. Unë e di që fuqia politike me vota është ndryshe, po të paktën, në këtë organ, i cili është organi më i lartë i vendit, duhet të dëgjohen zërat edhe të tjerëve që mendojnë ndryshe.

Unë edhe në lexim të parë i kam thënë disa argumente, por si duket nuk janë marrë për bazë nga komisionet funksionale, mendoj këto veprime janë të gabueshme dhe të dëmshme për demokracinë, tek e fundit e drejtë themelore e njeriut është e drejta për të zgjedhur dhe e drejta për t'u zgjedhur, dhe ky ligj nëse nuk përkrahen amendamentet që janë bërë nga disa deputetë, zoti Xhemajli, Tali edhe nga disa deputetë të tjerë që u thanë, unë mendoj që është cenim flagrant i të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Mua më vjen mirë që edhe nga disa deputetë të Partisë Demokratike, si partia më e madhe në vend, u shpreh një solidaritet për të vegjlit dhe tek e fundit edhe kjo është një parim i demokracisë dhe është një respekt që ka për t'u futur në Kuvendin e Kosovës, edhe forcat tjera politike që pretendojnë që janë në këtë Kuvend dhe jashtë tij.

Konsideroj që është mirë që Kuvendi ta trajtojë me seriozitet dhe të mbështetet amendamenti që ka të bëjë me uljen e pragut dhe mundësinë për kandidatë të pavarur.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, të nderuar deputetë,

Ju kam thënë disa herë gjatë diskutimeve në këtë Parlament se unë tërë jetën kam qenë opozitë dhe e kuptoj sa vështirë është të jesh opozitë, oponencë, sidomos kur je opozitë e një sistemi totalitar qysh ka qenë ish sistemi në të cilin kemi jetuar.

Megjithatë, unë e mbroj parimin që pragu zgjedhor nuk duhet të ulët dhe për këtë i kam edhe arsyet e mia. Ligjet zgjedhore kudo qofshin në botë, nuk janë ideale dhe nuk mund të bëhen për interesa, qofshin ato individuale, qofshin ato të grupeve të interesit, mirëpo, kur bëhet një ligj zgjedhor, merren parasysh shumë rrethana specifike të një shteti i cili dallon prej shteteve të ndryshme. Për këtë arsye duke u nisur nga specifikat që i ka shteti ynë si shtet i ri, si demokraci e re, dhe duke u nisur nga numri i banorëve që ka, dhe nga mundësia se në një vend prej 10 mijë kilometrash katrorë, çdo 5 veta mund të formojnë një parti politike, se e kanë koston shumë të ulët, dhe duke u nisur nga rrethanat tjera të cilat janë të sanksionuar me dispozita kushtetuese, në raport me minoritetet, ne, në vend se e ulim pragun zgjedhur në 3%, dhe nëse

krijojmë një dispozitë e cila u mundëson të pavarurve me 1% të hyjnë deputetë, ne nuk do të kemi kurrë institucione stabile dhe ne nuk mund të krijojmë kurrë një shumicë parlamentare e cila do të qeverisë në Kosovë. Duhet të kuptoni të gjithë se demokracia nuk është sistem ideal dhe nuk mund t'i vlerësojmë të gjitha kërkesat e individëve të caktuar, mirëpo gjithherë kur bëhen mazhurancat qeverisëse, kihet parasysh edhe stabiliteti i sistemit politik, stabiliteti qeverisës dhe konsistenca e programeve politike.

Për këtë arsye ekzistojnë edhe koalicionet parazgjedhore, ekzistojnë koalicionet pas zgjedhore dhe në këtë mënyrë, individë të caktuar duke bërë koalicione parazgjedhore, mund t'i paraqesin alternativat e tyre në Parlamentin e Kosovës.

Unë jam udhëtar se jam demokrat liberal me bindje, por me sinjeritetin më të madh po iu them, a mund ju ta paramendoni një Parlament me 40 deputetë të pavarur dhe si do ta arrijmë konsensus politik për aprovimin e një ligji kur të gjithë do të paraqitnin interesat ose të grupit ose të fisit ose të mëhallës. Në rast se shkojmë në uljen pragut 1% të jeni të bindur, çdo fshat i Kosovës, 50% të fshatrave të Kosovës do të kenë dike në Parlament dhe do të bëjnë politikë të mashallave dhe politikë të fiseve. Ky është parimi, që ne kur mendojmë për një sistem zgjedhor, duhet të kemi parasysh si do të funksionojnë institucionet demokratike në Kosovë, dhe duhet t'i plotësojmë standardet minimale ose disa standarde demokratike, mirëpo ekzistojnë parimet tjera të cilat mundësojnë që edhe alternativat politike edhe individë të caktuar, të jenë prezentë në Parlament.

Dëgjoni, me sinjeritetin më të madh po ua them, se individë të caktuar të cilët nuk mund ta gjejnë veten në asnjë parti politike, nuk mund të bëjmë ligj për ego personale dhe interesat personale dhe interesat personale të individëve, të cilët nuk mund të gjejnë veten në një parti politike. Aderimi në një parti politike do të thotë edhe heqje dorë nga një pjesë e integritetit dhe sovranitetit edhe të lirisë personale. Këto janë rregulla, partia funksionon mbi parimin e normave, rregullave dhe dispozitave të caktuara dhe mazhurancat e qëndrueshme parlamentare, krijojnë stabilitet politik dhe stabilitet qeverisës. Për këtë arsye unë e mbroj parimin e shumicës në Kosovë që pragu zgjedhur të jetë ashtu siç e ka propozuar edhe Komisioni funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI : Deputetja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ BUJUPI: Për amendamentin e pestë, e kam fjalën.

KRYESUESI: Atëherë, nuk ka më të paraqitur.

Votojmë amendamentin e katërt.

Në fillim janë dy propozime, pa mbështetje të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me arsyetime se është referuar në ligjin në fuqi që nuk është objekt trajtimi.

Megjithatë, votojmë propozimin e parë- propozimin e deputetit Driton Tali.

Njëjtë, okej, atëherë i votojmë veç e veç të dy propozimet nuk kanë mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Votojmë në fillim propozimin e deputetit Driton Tali. Unë e kam një, por ata po thonë se janë dy propozime. U bë, një amendament.

Shikoni, nëse kalon amendamenti, kalon, nëse nuk kalon nuk kalon as a-ja, as b-ja, kjo është. Një amendament unë e kam këtu, dhe kështu e ka administruar komisioni në fjalë.

Votojmë amendamentin 4.

Votojmë tani.

E keni parë që nuk kalon amendamenti.

Pra, 61 vota janë “kundër” 14 vota “për” dhe 7 abstenime.

Vazhdojmë me amendamentin 5.

Nuk është, mirëpo ma kanë shkruar komisionet një amendament.

Amendamenti 5, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me arsyetimin se është referuar në ligjin në fuqi, i cili nuk ishte objekt trajtimi.

Për fjalë është paraqitur deputetja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ BUJUPI: Ju faleminderit,!

I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me qëllim të saktësimit të asaj çka u tha pak më herët këtu dhe duke marrë parasysh që u tha një diçka që ka devijuar nga puna e Grupit të Grave Parlamentare, të cilat kanë marrë iniciativën për plotësim- ndryshimin e Ligjit zgjedhor, më 29.9.2009, më lejoni që të shpreh qëndrimet e mia, si zëvendës kryesuese e këtij grupi, mirëpo janë qëndrime pas një konsultimi gjatë pauzës edhe të grupeve tjera parlamentare si të LDK-së dhe të LDD-së, dhe komuniteteve. Asnjëherë Grupi i Grave deputete nuk ka kërkuar që numri i të votuarve apo lista e të votuarve të zëvendësohet me numrin 10, prandaj për shkak të korrektësisë dëshiroj që kjo të mbetet edhe në transkripto. Dihet cili ka qenë qëndrimi dhe kërkesa e Grupit të Grave Parlamentare, ky qëndrim dhe kjo kërkesë është nënshkruar nga 82 deputetë të Kuvendit të Kosovës, dhe sot unë nuk dëshiroj që për interesa të grupeve të caktuara politike të luhet me nënshkrimin e këtyre deputetëve ose të thirret dikush në emrin tim, sepse nuk qëndron ashtu, ose në emrin e bordit.

Absolutisht nuk do dëshiroja asnjëherë që të shkelin vullnetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ne kemi ofruar si grup i grave një dokument i cili është nënshkruar kohë më parë. Për arsye të caktuara nuk është sjellë në Kuvendin e Kosovës, për më tepër ka ekzistuar një grup punues për zgjedhje, ku është përfaqësuar edhe Grupi Parlamentar Joformal i Grave. Pra, kemi pasur aty përfaqësuesen tonë, të gjitha vendimet aty janë marrë me koncensus dhe nuk është në rregull që në minutën e fundit të kamuflohen amendamentet e tilla po them edhe një herë me qëllim të interesave të ngushta politike të grupeve të caktuara politike, dhe të thirret apo të prezantohet si qëndrim i grupit të grave parlamentare.

Ky nuk është qëndrim i Grupit të Grave Parlamentare, numri 10 të jemi shumë të qartë, të saktë dhe të jemi fer edhe korrekt, se nuk kemi ardhur për të bërë hajgare, por kemi ardhur për ta mbrojtur ligjin, kemi ardhur të punojmë konform ligjit, ju lutem.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, atëherë amendamenti i pestë, siç thashë, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tani.

Nuk miratohet amendamenti.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët për përgatiten për votim.
Votojmë tani.

Në sallë janë 85 deputetë.

Konstatohet se me 81 vota për, 1 abstenim, 2 kundër, Kuvendi miratoi Ligjin për plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e ish të burgosurve politikë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë.

Jam shumë i nderuar që kam rastin që sot të paraqes raportin e punës së Komisionit për leximin e dytë të Projektligjit për të burgosurit politikë, dhe vlen që t'ju them kërkojmë falje nëse është lëshuar ndonjë gabim teknik i cili nuk e ndryshon përmbajtjen e Projektligjit për shkak të rrethanave në të cilat kemi punuar dhe pikërisht kërkojmë ndoshta që nga administrata të ketë kujdes me rastin e harmonizimit edhe pse e kemi thënë në fund të projektligjit. Projektligji është hartuar konform standardeve të cilat po i hartojmë edhe ligjet e tjera, natyrisht që nuk kemi arritur që të rregullojmë komplet statusin apo t'i rregullojmë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që duhet t'i kishin realizuar me këtë ligj të burgosurit politikë si një kategori e cila ka sakrifikuar shumë për Kosovën por, megjithatë, besoj që 23 amendamente të cilat janë bërë e kanë rregulluar në atë formë ligjin që do të ketë një përmbajtje të qartë, do të ketë një përmbajtje të zbatueshme, dhe natyrisht që kemi lënë mundësinë që me aktet nënligjore të cilat do t'i nxjerrë Qeveria më vonë, të rregullojë pozicione të veçanta. Unë nuk do të lëshohem nëpër amendamente, sepse ju njoftoj të gjitha komisionet parlamentare nuk kanë bërë amendamente shtesë, nuk kanë bërë as deputetët e nderuar amendamente shtesë, por vetëm kërkoj që në amendamentin 11, nëse më lejohet të bëjmë një plotësim, atëherë do ta bëj kur të vijmë te amendamenti.

Ju kisha lutur që të ma jepni fjalën, sepse është me rëndësi përmbajtjesore. Edhe një herë duke u falënderuar të gjithë anëtarëve të Komisionit për Legjislacion duke falënderuar në veçanti edhe stafin e administratës që kanë qenë deri në orët e vona komisionet e përhershme në të gjithë deputetët që sot vendosën ta procedojnë ligjin, kërkoj që edhe t'i aprovojmë amendamentet e propozuara.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar Gani Koci.

GANI KOCI: Sipas nevojës, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar edhe ligjin, Projektligjin dhe amendamentet e Komisionit funksional lidhur me ligjin në fjalë. Ka konstatuar

se edhe i tërë ligji dhe amendamentet përmbajnë implikime buxhetore dhe këto implikime buxhetore mund të dihen vetëm atëherë kur të nxirren aktet për zbatimin e këtij ligji nga Qeveria që janë afatet e caktuara dhe në cilat raste duhet të nxirren këto akte si instrumente për zbatimin e ligjit, dhe ka konsideruar se ky projektligj me të gjitha amendamentet duhet të miratohet. Gjithashtu e përmendi edhe kryetari i Komisionit funksional, Komisioni ka pasur vërejtje te amendamenti 11 te pjesa e fundit që ka të bëjë me nenin 9, dhe ka propozuar që në vend të asaj siç është thënë dhe ... na ka përshpejtuar se ka kaluar disi, kur është çështja te njohja e kohës, qëndrimit në burg si stazh i punës, stazh i dyfishtë i punës, që është praktikë e të gjitha vendeve që kanë këso kategorie të njerëzve, prandaj Komisioni ka propozuar që vërtet në pjesën e fundit të amendamentit 11 të thuhet kështu: koha e kaluar në burg njihet si stazh i dyfishtë i punës për ish të burgosurit dhe të dënuarit politikë, që është një standard që po e aplikojnë në vende tjera dhe në këtë mënyrë të kihet parasysh. Kjo është bërë edhe në bisedë me Komisionin funksional në këtë rast, përndryshe duhet të miratohen amendamentet.

KRYESUESI : Në emër të komisioneve nuk ka të paraqitur, vazhdojmë me projektligjet e propozuara gjithsejtë 23 amendamente, nga komisioni funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitur në raport. Amendamenti i parë, në qoftë se ka dikush fjalën për amendamentin e parë mund të flas. Zoti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit! Kështu, apriori do të votoj për, mirëpo nuk është e dhënë ajo elementarja e teknikës juridike, ishte dashur të jepet teksti i atyre paragrafëve të cilat do të hiqeshin, apo jo? Kjo d. m. th. është elementare në nomoteknikë, sepse është rregull pa të cilin nuk bën. Për hir të rrethanave etj. të rëndësisë së këtij dokumenti do të votoj, për deri sa jam i njohur me këtë, por ka shumë, apo mund të ketë shumë që nuk e kanë lexuar, nuk e dinë edhe tash nuk do të ishte bash korrekte që të votohet për, e mos të dihet se cilat dispozita do të hiqeshin. Kjo është e përsëritur në disa paragrafë të tjera. Këtë vërejtje parimore. Ju faleminderit!

KRYESUESI : Ju faleminderit!

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tani.

Në sallë janë 75 deputetë.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 4

Amendamenti 5

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

KRYESUESI: Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit zoti kryesues!
Unë do ta sjell me shkrim , por do ta lexoj për hir të deputetëve, propozoj që të mbetet neni 9 me këtë riformulim: koha e kaluar në burg, njihet si stazh i dyfishtë i punës për të burgosurit dhe të dënuarit politikë. Do ta dorëzoj tani në administratë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Bajram Kosumi e ka kërkuar fjalën.

BAJRAM KOSUMI: Meqenëse kam qenë kryesues i grupit punues për këto amendamente, dëshiroj të shpreh përkrahjen time të plotë për propozimin e zotit Hyseni, dhe po ashtu një përmirësim të vogël që mund të mos kuptohet te amendamenti 11 pika 8.2 , fjala e fundit vakant, mund të krijojë keqkuptim duhet, veçantë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: E hedh në votim me plotësimet që u dhanë në amendamentin e 11.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 23.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Në sallë janë 80 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Konstatohet se më 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për të drejtat e ish të dënuarve politikë dhe të përndjekurve politikë.
Ju faleminderit!

Seanca e radhës është caktuar të martën, më 2 nëntor 2010.

Ftesa me materiale është duke u shpërndarë në postën e deputetëve. Mirupafshim në seancën ardhshme, në orën 12:00!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës

